

**ZGJIDHJE PËRMES POLITIKAVE
NË SEKTORIN E ENERGJISË
NË KOSOVË**



KOSID

KOSOVO CIVIL SOCIETY CONSORTIUM FOR
SUSTAINABLE DEVELOPMENT

KONSORCIUMI KOSOVAR I SHOQËRISË CIVILE PËR
ZHVILLIM TË QËNDRUESHËM



KOSID

KOSOVO CIVIL SOCIETY CONSORTIUM FOR
SUSTAINABLE DEVELOPMENT

KONSORCIUMI KOSOVAR I SHOQËRISË CIVILE PËR
ZHVILLIM TË QËNDRUESHËM

Hyrje

Gjatë viteve në vijim, Kosova do të ballafaqohet me sfida në energjetikë, veçanërisht në sektorin e energjisë elektrike. Prodhimi aktual nuk do të jetë në gjendje të përmbushë kërkesat e projektuara të vendit. Dallimi në mes të kërkesës dhe furnizimit bëhet edhe më i thellë kur merret parasysh shfrytëzimi i joefiçient i energjisë elektrike, humbjet e mëdha teknike, shfrytëzimi i energjisë elektrike për ngrohje dhe mungesa e veprimeve përmirësuese për eficiencë të energjisë.

Aktualisht, shumica dërrmuese e energjisë në Kosovë prodhohet nga dy termocentrale shumë të vjetra me linjit. Qeveria e Kosovës po përpiqet që të zgjidhë krizën energjetike duke planifikuar ndërtimin edhe të një termocentrali me linjit, duke injoruar plotësisht elementet tjera të cilat përbëjnë këtë krizë. Politikat e eksploatimit të rezervave të linjitet, të cilat janë përfshirë në Strategjinë e Kosovës për Energji, janë të shtrenjta, të paqëndrueshme, joadekuate dhe të panevojshme.

Në këtë punim, kemi paraqitur zgjidhje përmes politikave për sektorin energjetik të Kosovës. Këto zgjidhje bazohen në hulumtimin gjithëpërfshirës dhe aktivitetet tjera të zhvilluara nga Konsorciumi Kosovar i Shoqërisë Civile për Zhvillim të Qëndrueshëm (KOSID) gjatë katër vjetëve të fundit. Ai bazohet në parimet e zhvillimit të qëndrueshëm dhe atyre të Acquis të Bashkimit Evropian.

Objektiv i këtij punimi është të ofrojë zgjidhje përmes politikave të cilat do të sigurojnë furnizim të qëndrueshëm, të përballueshëm, të sigurt dhe miqësor ndaj ambientit. Ky objektivi përkon me objektivat e Qeverisë së Kosovës. Ai paraqet drejtimin e përgjithshëm dhe masat e veçanta politike të cilat dallojnë prej atyre qeveritare. Ky dokument do të elaborojë shkurtimisht këto masa.

KOSID-i beson fuqishëm se qëndrueshmëria është faktori më i rëndësishëm i cili duhet të merret në konsideratë para se të vendoset rreth politikave energjetike. Prandaj, KOSID kërkon që të garantohet siguri energjetike përmes ndërtimit të kapaciteteve prodhuese të shumëllojshme, përdorim të burimeve të ripërtërishme të energjisë dhe integritit në rrjetet rajonale elektrike. Ne kërkojmë që të ofrohen çmime të përballueshme të energjisë, duke eliminuar humbjet e energjisë dhe duke aplikuar masat e eficiencës së energjisë, të cilat mund të ulin ndjeshëm kërkesën. Së fundi, ne kërkojmë që të sigurohet një shoqëri e shëndetshme dhe një mjedis më i mirë, duke marrë me kujdes në konsideratë burimet tona natyrore.

Kërkesat bazë të Kosovës për energji mund të plotësohen përmes termocentralit të rinovuar “Kosova B”. “Kosova A” planifikohet të mbyllet deri në fund të vitit 2017 dhe ne vazhdojmë të mbështesim këtë plan. “Kosova B” duhet rinovuar për të përmbushur kriteret teknike dhe mjedisore të përshkruara nga Komuniteti i Energjisë dhe BE-ja. Nuk janë të nevojshme kapacitete të reja prodhuese nga linjiti, ngase aplikimi i masave, që përfshijnë reduktimin e humbjeve, ngritjen e eficiencës së energjisë si dhe shfrytëzimin e burimeve të ripërtërishme të energjisë, do të mundësojnë plotësimin e kërkesave.

KOSID-i beson se veprimi më i rëndësishëm është radhitja e zbatimit të këtyre nismave. Prandaj, ky punim, si hap të parë, sugjeron një program intensiv dhe gjithëpërfshirës të eficiencës së energjisë, të kombinuar me masa agresive për të reduktuar humbjet teknike në rrjet. Duke shfrytëzuar mjetet financiare që janë premtuar tashmë si ndihma, kreditë nga institucionet financiare ndërkombëtare dhe me më shumë mbledhje të fondeve, këto politika parashikojnë krijimin e një Fondi për Eficiencë të Energjisë që do të zbatonte një program nacional për eficiencë. Këto masa, të përshkruara më poshtë, do të ulin kërkesën e përgjithshme për energji. Ato duhet pasuar nga integrimi i mëtejshëm i Kosovës në rrjetet rajonale energjetike, përmes kredive dhe ndihmave të ofruara nga institucionet financiare ndërkombëtare. Masat përcjellëse si zgjidhjet alternative për ngrohje do të ulnin më tej kërkesën, duke e sjellë atë në shkallë reale.

Hapi i dytë do të përfshijë ndryshimin e politikave me qëllim që Kosova të bëhet një vend tërheqës për kompanitë e energjisë alternative. Kjo do të përfshijë edhe Qeverinë e cila do të eksplorojë potencialet e energjisë që do të mund të prodhojë nga burimet e ripërtërishme në vend. Përdorimi i mundshëm i energjisë së rinovueshme do të kontribuojë jo vetëm në prodhimin e përgjithshëm, por do të adresojë edhe çështjen e sigurisë së energjisë. Për më tepër, sektori i energjisë së ripërtërishme do të mund të bëjë sektor i rëndësishëm për krijimin e vendeve të punës në Kosovë.


Renditja e këtyre masave e bën këtë qasje të përshtatshme dhe të qëndrueshme, duke ia mundësuar asaj të sjellë rezultate më të mira në një periudhë të shkurtër kohore, me pak investime. Kjo qasje do të lejojë që çmimi i energjisë të mbetet i ulët, gjersa plotësohen kërkesat e vendit për energji elektrike. Skenari më i mirë për Kosovën do të ishte kalimi nga prodhimi i sasive më të mëdha të energjisë të ngritja e eficiencës elektrike dhe nga përdorimi i lëndëve djegëse fosile te përdorimi i burimeve të ripërtërishme. Kjo do t'i mundësonte Kosovës të përmbushë kërkesat e saj për energji me çmim të përballueshëm. Pa pasur nevojë për djegien e linjitit për 40 vjetët e ardhshëm, ky plan është më miqësor ndaj ambientit dhe ndaj shoqërisë.

Prodhimi


Studimet rreth rezervave të linjimit të Kosovës flasin për një sasi prej 14.7 miliardë tonë, të cilat e bëjnë Kosovën rezervën e pestë më të madhe në botë¹. Pjesa dërrmuese e rezervave të linjimit ndodhet në thellësi të cekëta nën sipërfaqen e tokës. Sipas normës aktuale të shfrytëzimit të linjimit, llogaritet se në Kosovë ka sasi të mjaftueshme të linjimit edhe për 1500 vitet e ardhshme. Duke marrë parasysh këto rezerva të mëdha, nuk është për t'u habitur se pothuajse e gjithë energjia elektrike në Kosovë prodhohet nga djegia e linjimit, gjithashtu arsyeja që institucionet kosovare dhe ato ndërkombëtare janë të obsesionuar pas tij.

Fatkeqësisht, linjiti i Kosovës ka veti shumë të ulëta energjetike, mesatarisht 7.8 MJ për kilogram të linjimit. Për më tepër, nivelet e larta të lagështisë dhe hirit, 35-50% dhe 14-17% respektivisht, kontribuojnë më tutje në përdorim të kufizuar të linjimit. Vlerat e ulëta energjetike kufizojnë përdorimin e tij vetëm në termocentrale me kapacitete të mëdha gjeneruese, me kosto të lartë mjedisore dhe shëndetësore.

Aktualisht, termocentralet e Kosovës lirojnë rreth 5,8 milionë tonë dyoksid karboni (CO₂) në atmosferë çdo vit². Kjo ndotje vjen nga dy termocentralet me linjit "Kosova A" dhe "Kosova B". "Kosova A" është ndërtuar gjatë viteve të gjashtëdhjeta me teknologji sovjetike, ndërsa "Kosova B" është ndërtuar gjatë viteve të tetëdhjeta. "Kosova A" përbëhet nga pesë blloqe, dy prej të cilave janë jashtë përdorimit për shkak të vjetërsisë dhe ndikimit të tyre të tmerrshëm në mjedis, përderisa "Kosova B" përbëhet nga vetëm dy. Kapaciteti i instaluar i "Kosovës A" është 800 MW, edhe pse sot në dispozicion janë vetëm 350 MW. Në anën tjetër, "Kosova B" ka një kapacitet total



- 1 Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale, <http://www.kosovo-mining.org/kosovoweb/en/mining/minerals.html>
- 2 Opsionet e qëndrueshme energjetike për Kosovën: Një analizë e disponueshmërisë së burimeve dhe koston, Daniel M. Kammen, Maryam Mozafari dhe Daniel Prull, 2012 <http://coolclimate.berkeley.edu/sites/all/files/Kosovo20May2012.pdf>



të instaluar prej 678 MW, edhe pse momentalisht në dispozicion janë vetëm rreth 500 MW. “Kosova A” konsiderohet ndër ndotësit më të mëdhenj në Evropë. Ky termocentral liron përafërsisht 2.5 tonë hi në orë. Për më tepër, teknologjia e tij është aq e vjetër dhe e amortizuar, sa që kur llogaritet kostoja e amortizimit të aseteve të tij, ajo mezi ndikon në çmimin përfundimtar. Kjo rezulton në një shkallë shumë të ulët të efijencës dhe në një situatë në të cilën ka pak hapësirë për përmirësim. Duke marrë parasysh këto fakte, termocentrali “Kosova A” duhet të mbyllet deri në fund të vitit 2017, siç parashihet në Traktatin me Komunitetin e Energjisë dhe në bazë të zotimeve të Qeverisë së Kosovës se zgjatja e jetës së këtij termocentrali nuk duhet të merret në konsideratë, pavarësisht rrethanave.


Djegia e linjtit me qëllim të gjenerimit të energjisë elektrike do të mbetet burimi kryesor i energjisë në Kosovë. Furnizimi bazë i energjisë do të vazhdojë përmes termocentralit “Kosova B”. Për të ngritur normën e efijencës, për të minimizuar humbjet dhe për të sjellë parametrat e termocentralit në nivel të standardeve të pranueshme të Bashkimit Evropian, “Kosova B” duhet të rinovohet deri më 2017. Rinovimi do të përmirësojë normën e konvertimit të ngrohjes, do të rrisë kapacitetet e saj të gjenerimit dhe do të ulë numrin e rënieve të papritura nga sistemi. Rinovimi do të rezultojë me një termocentral që i plotëson standardet e BE-së dhe që do të sigurojë furnizimin bazë të energjisë për Kosovën.

Duke trajtuar çështjen e furnizimit bazë me energji përmes termocentraleve të linjtit, Kosova nuk ka nevojë për të zgjeruar më tej kapacitetet për djegie të linjtit. Pjesa tjetër e energjisë duhet dhe mund të realizohet përmes investimeve të duhura në energjinë e ripërtërishme dhe në ngritjen e efikasitetit të energjisë, siç dëshmojnë edhe studimet e Laboratorit për Energji të Ripërtërishme në Universitetin e Berkeley-it³. Prandaj, Kosova nuk duhet të ndërtojë kapacitete të reja energjetike me linjit.

Sektori i energjisë në Kosovë do të kërkojë investime të konsiderueshme, si financiare ashtu edhe në drejtim të ndërtimit të kapaciteteve, pa marrë parasysh se cili plan i energjisë do të ndiqet. Një përbërës i rëndësishëm i çdo strategjie zhvillimi të qëndrueshme për Kosovën është dialogu i vazhdueshëm dhe transparent mes donatorëve dhe Qeverisë së Kosovës. Kjo është veçanërisht e rëndësishme për shkak se resurset ndërkombëtare do të jenë të nevojshme në cilëndo agjendë që promovon rritjen ekonomike dhe ruajtjen e mjedisit në Kosovë dhe rajon.

Me mbylljen e termocentralit “Kosova A”, pjesa tjetër e hendeikut energjetik në Kosovë mund të plotësohet lehtë me burime të ripërtërishme të energjisë, për shkak të potencialit të tyre të konsiderueshëm. Fatkeqësisht, mentaliteti i hartuesve të politikave ka qenë ai i shfrytëzimit të linjtit dhe deklarimeve të pasakta se Kosova nuk ka kapacitete të energjisë së ripërtërishme. Megjithatë, në vitin 2013, kur u miratua Plani Kombëtar i Veprimit për Energji të Ripërtërishme (PKVER), doli se Kosova ka më shumë potencial të energjisë së ripërtërishme se që është menduar më parë. Megjithatë, edhe PKVER-i nuk ka marrë parasysh gjithë kapacitetin për energji të ripërtërishme dhe ky fakt duhet të adresohet.

Kosova, as sot, nuk ka një hartë të besueshme të erërave dhe potenciali i shfrytëzimit të energjisë së erës mbetet i pa eksploruar. Deri në nëntor të vitit 2013, 5 kompani



3 Opsionet e qëndrueshme energjitike për Kosovën: Një analizë e disponueshmërisë së burimeve dhe kostos, Daniel M. Kammen, Maryam Mozafari dhe Daniel Prull, 2012
<http://coolclimate.berkeley.edu/sites/all/files/Kosovo20May2012.pdf>

kanë aplikuar për licencë të shfrytëzimit të përgjithshëm të potencialit që llogaritet diku 164.5 MW. Për më tepër, ZRRE-ja tashmë ka licencuar një operator të vogël të kapacitetit prej 900 kilovatësh. Aktualisht, kapacitetet që presin për licencim tejkalojnë kapacitetin prej 150 MW që PKVER-i parasheh të instalohen deri në vitin 2025. Nga ana tjetër, një studim nga Agjencia Gjermane për Zhvillim Ndërkombëtar (GIZ) (edhe pse ende e papublikuar) arrin në përfundim se Kosova ka potencial të energjisë së erës prej më shumë se 300 MW⁴. Një histori e ngjashme ka përcjellë edhe kapacitetet e ujërave të Kosovës. Deri në vitin 2006, përveç hidrocentralit të madh të Zhurit (300 MW), nuk kishte kapacitete të tjera në horizont. Ministria e atëhershme e Energjisë kreu një studim i cili pat gjetur se ka potencial të fuqishëm për 18 hidrocentrale të vogla, me kapacitet totale prej 63 MW-ve. Deri në vitin 2013, Qeveria e Kosovës ka në plan instalimin e rreth 240 MW-ve në formë të hidrocentraleve të vogla. Sa i përket hidrocentralit të Zhurit shumë pak është bërë. Edhe pse një studim i fizibilitetit për projektin ekziston që nga vitet 1970 dhe një tjetër studim fizibiliteti është kryer në vitin 2009, projekti ka ngecur për një kohë të gjatë. Kjo ngre pyetje rreth përkushtimit të Qeverisë në projekte energjetike që nuk përfshijnë shfrytëzimin e linjitetit si burim. Hidrocentrali i Zhurit duhet të ndërtohet sa më shpejt të jetë e mundur, pasi ai paraqet një mundësi të madhe për mbulimin e një pjese të kërkesës gjatë kohës së pikut, për të cilën Kosova ka nevojë më së shumti.

Pak studime janë kryer mbi kapacitetet e burimeve të tjera të energjisë së ripërtërishme. Është krijuar një situatë që ofron hapësirë për pretendime të tilla se Kosova ka pak kapacitete të energjisë së ripërtërishme. Për shembull, kapacitetet gjeotermike janë lënë tërësisht pas dore, edhe pse ka kapacitete të konsiderueshme për shfrytëzim, duke u bazuar në hartat e vjetra gjeotermike jugosllave dhe duke krahasuar Kosovën me kapacitetet gjeotermike të vendeve fqinje. Një studim i duhur për eksplorimin e kapaciteteve gjeotermike duhet të kryhet. Ngjashëm, biomasa gjithashtu është lënë pas dore. PKVER-i parashikon instalimin e vetëm 10 MW-ve të kapaciteteve me biomasë deri në vitin 2025. Megjithatë, studime të tjera kanë sugjeruar përdorimin e 164 MW-ve⁵ deri në vitin 2025 dhe 150 MW-ve⁶ deri në vitin 2030.

4 Vlerësimet për potencialin e energjisë së rinovueshme janë marrë nga studime të ndryshme të bëra në këtë fushë. Për më shumë informata, ju lutem shihni studimet në vijim:

Opsionet e qëndrueshme energjetike për Kosovën: Një analizë e disponueshmërisë së burimeve dhe kostos, Daniel M. Kammen, Maryam Mozafari dhe Daniel Prull, 2012

Studim rreth sigurisë së furnizimit elektrik në Kosovë, KOSTT, 2013.

http://www.kostt.com/website/images/stories/dokumente/publikime/Report_REV15_i_publikuar_ne_web.pdf

Plani Kombëtar i Veprimit për Energji të Rinovueshme (NREAP) 2011 – 2020, Republika e Kosovës, 2013

<http://www.energy-community.org/pls/portal/docs/2570177.PDF>

Studim: Zhvillimi dhe vlerësimi i opsioneve për furnizim me energji elektrike për Kosovën, Banka Botërore, 2011.

http://siteresources.worldbank.org/INTENERGY2/Resources/Kosovo_generation_options_report_12312011.pdf

Zyra Ndërlidhëse e Komisionit Evropian në Kosovë Kosovë, Ministria për Energji dhe Miniera, qershor 2008

Rishikim i Hidrocentralit të Zhurit, Studimi i Fizibilitetit duke përfshirë edhe përgatitjen e Vlerësimit Preliminar të Ndikimit Mjedisor dhe Vlerësimin Preliminar Social, Republika e Kosovës, 2009

http://mzhe.rks-gov.net/repository/docs/Revized_Final_Report_Zhur_en.pdf

Energjia e rinovueshme si Mundësi për Zhvillim Ekonomik në Kosovë, GIZ, 2012.

5 Studim rreth sigurisë së furnizimit elektrik në Kosovë, KOSTT, 2013.

http://www.kostt.com/website/images/stories/dokumente/publikime/Report_REV15_i_publikuar_ne_web.pdf

6 Opsionet e qëndrueshme energjetike për Kosovën: Një analizë e disponueshmërisë së burimeve dhe kostos, Daniel M. Kammen, Maryam Mozafari dhe Daniel Prull, 2012

<http://coolclimate.berkeley.edu/sites/all/files/Kosovo20May2012.pdf>

Së fundmi, kapacitetet e energjisë solare kanë qenë ndër temat më kundërthënëse në mesin e burimeve të energjisë. Kapaciteti i parashikuar për Kosovën ka variuar nga 1 MW në vitin 2025, në 75 MW deri në vitin 2025 dhe 200 MW deri në vitin 2030. Megjithatë, shumica e shfrytëzimit të energjisë solare nuk përcaktohet nga sasia e motit me diell, pasi që kjo nuk duket të jetë problem për Kosovën, por nga çmimi i energjisë solare dhe teknologjisë përcjellëse. Parametër kyç për të përcaktuar këtë (tarifa “feed-in”) mungon në Kosovë. Edhe pse ishte premtuar nga institucionet përgjegjëse se kjo tarifë do vendoset deri në fund të vitit 2013, deri më sot ajo ende mungon. Mungesa e tarifës “feed-in” paraqet një pengesë të madhe në zhvillimin e tregut të energjisë solare në Kosovë.


Kostoja e energjisë së ripërtërishme që nga viti 2010 ka rënë në mënyrë të konsiderueshme me reduktime të shënuara në PV-të diellore dhe çmime të gjenerimit përmes erës, për shkak të zgjerimit të kapaciteteve globale. Me zvogëlimin e çmimit të PV-ve deri në 0,72 \$ / W në vitin 2013, me zhvillimin e vazhdueshëm të njohurive rreth prodhimit të energjisë dhe përmirësimeve në materialet në industrinë fotovoltaike, kostoja për të gjeneruar energji solare në Kosovë është shumë më konkurruese sesa modelet e mëparshme të cilat janë marrë në shqyrtim për zëvendësimin e termocentralit me linjit “Kosova B”⁷. Për më tepër, natyra plotësuese e turbinave të erës, energjisë solare dhe masat për efikasitet mund të mblidhen në një portofol të energjisë me çmim më të ulët kapital, social dhe shëndetësor se sa 600 MW-të e gjeneruara përmes djegies së linjtit. Kostoja e gjenerimit me erë pritet të zvogëlojë LCOE-të për 20-30% deri në vitin 2030. Prandaj, planifikimi i ardhshëm do të përfshijë një pjesë dukshëm më të madhe të energjisë me erë, sesa që është e instaluar aktualisht⁸. Këto ndryshime dëshmojnë nevojën për një skenar me nivel më të ulët të karbonit që plotësojnë nevojat e tanishme dhe të ardhshme të Kosovës për energji dhe ofrojnë siguri energjetike dhe mbrojtje shëndetësore.

7 Zheng, Cheng, dhe Daniel M. Kammen. 2014. Një udhërrëfyes i fokusuar në inovacione për një industri globale fotovoltaike të qëndrueshme. *Energy Policy* 67: 159-169.

8 Lantz, E., Wisser, R., Hand, M., 2012. IEA Wind Task 26: Kostoja në të kaluarën dhe në të ardhmen e energjisë me erë. National Renewable Energy Laboratory.

Eficienca e Energjisë

Eficienca është pika më e dobët e sektorit të energjisë në Kosovë dhe njëkohësisht edhe objektivi më i lehtë për t'u arritur. Si i tillë, ajo është ndër prioritetet kryesore të KOSID-it. Prioritet i politikave energjetike në Kosovë duhet të jetë ulja e kërkesës për energji në mënyrë që të ulen faturat e energjisë elektrike, bërja më e përballueshme për popullsinë e varfër dhe shmangia e nevojës për një termocentral të ri me linjit. Potenciali për të shfrytëzuar masat e efijencës është i madh të paktën në fushat në vijim.



Humbjet totale në vitin 2012

Zhvillimi dhe mirëmbajtja e një rrjeti të përshtatshëm të energjisë elektrike është jetik për sigurimin e furnizimit me energji me kosto më të ulët. Joeficienca e rrjetit shpërndarës të Kosovës kontribuon në humbje të mëdha të energjisë. Humbjet në rrjet në vitin 2012 arritën në 36,69% të energjisë së përgjithshme të bartur përmes rrjetit shpërndarës, ndërsa në vitin 2011 ishte 38.15%⁹. Rreth 20% mendohet të jenë humbje komerciale, ose vjedhje të energjisë elektrike. Humbja e energjisë mbetet një problem serioz, andaj çdo politikë energjetike duhet ta ketë prioritet menaxhimin e tyre, edhe pse ka pasur një ulje të lehtë të humbjeve gjatë viteve të fundit. Objektivat aktuale për reduktimin e humbjeve teknike janë 1% në vit. Kjo duhet të ndryshojë në mënyrë që Kosova të reduktojë humbjet në një kuotë të pranueshme prej 7% deri në vitin 2015, kur tregu i energjisë pritet të liberalizohet. Kjo mund të arrihet duke shfrytëzuar investimet e premtuara, qoftë nga kompania afariste KEDS (Furnizimi dhe Shpërndarja e Energjisë së Kosovës) qoftë nga kompani që kanë premtuar investime deri në 300 milion euro për këtë qëllim, ose edhe investime shtesë nga burime të tjera.

Mekanizmi i parë që do të ndihmojë në përmbushjen e objektivit të tillë do të ishte instalimi i njehsorëve elektrik “të zgjuar” për të gjithë konsumatorët e energjisë në vend. Kjo masë do të ndihmojë në reduktimin si të humbjeve komerciale, ashtu edhe atyre teknike të sistemit energjetik.

Masat e para për përcaktimin e prioriteteve të efijencës në Kosovë duhet të mbulojnë sektorin publik ku kursimet më të mëdha të energjisë mund të ndodhin në afat më të shkurtër kohor. Masa të tilla mund të merren si në nivel qendror, ashtu edhe atë komunal dhe mund të përbëhen nga nisma legjislative, marrëveshje në baza vullnetare, sisteme të menaxhimit të energjisë, përcaktime dhe zbatime të kritereve të efijencës së energjisë

⁹ Zyra e Rregullatorit të Energjisë (ZRRE), Raporti Vjetor, 2012.

gjatë prokurimit të mallrave dhe shërbimeve, resurse të ESCO-s, kontrata të performancës energjetike ose skema të tjera ekuivalente. Hapi i parë drejt një mekanizmi të tillë do të ishte auditimi i efijencës për të gjitha ndërtesat publike nga ana e Qeverisë.

Një akt nënligjor i cili urdhëron zëvendësimin e të gjithë poçave elektrik në ndërtesat publike si dhe në rrjetet e ndriçimit të rrugëve të qyteteve, duhet të nxirret në përputhje me këto dokumente të politikave. Përveç kësaj, qeveria do të vazhdojë të stimulojë ekonominë familjare për zëvendësimin e poçave elektrik. Një studim krahasues i kryer në Universitetin e Prishtinës ka treguar se Kosova do të mund të mbyllte një nga gjeneratorët e termocentralit “Kosova A” nëse zëvendësohen poçat elektrik inkandeshentë me ata më eficient. Masa të mëtejshme do të ishin instalimi i paneleve solare për qëllime sanitare në të gjitha ndërtesat publike, termo-izolimi i mureve dhe çative, si dhe gjetja e opsioneve të qëndrueshme për ngrohje, për të cilën gjë edhe shfrytëzohet shumica e energjisë gjatë dimrit. Sektori i ndërtesave, i cili përbëhet nga sektori i ndërtesave familjare dhe sektorit të shërbimeve publike dhe private llogaritet se përbën 48% të konsumit të energjisë dhe përfaqëson pjesën më të madhe të konsumit final të energjisë të Kosovës¹⁰. Ndërtesat publike për momentin ofrojnë mundësi më të mira për arritjen e kursimit të vërtetë të energjisë, sepse në shumë raste ato tashmë përmbushin kriteret e kërkuara.

Për të siguruar përmbushjen e këtyre objektivave ambicioze deri në vitin 2020, BE-ja vlerësoi si të nevojshme “Pakon e tretë” të masave urgjente. Në tetor të vitit 2012, BE-ja miratoi një Direktivë për Efijencën e Energjisë 2012/27/EU që zëvendëson direktivën aktuale 2006/32/EC. Dispozitat nga kjo Direktivë duhet të reflektohen në ndryshimet e Ligjit për Efijencë të Energjisë të Kosovës, të cilat janë planifikuar të ndodhin këtë vit. Ligji aktual për Efijencë të Energjisë rregullon vetëm sektorin publik dhe lë anash atë privat.

Një ligj tjetër që ndikon në efijencën e energjisë është Ligji për Ndërtimet, i cili është miratuar më 31 maj 2012. Ky ligj përcakton zbatimin e masave të efijencës së energjisë të ndërtimit. Ligji parashikon që masat e efijencës të jenë një nga objektivat e “Kodit të Unifikuar të Ndërtimit të Kosovës”¹¹. Ndërtimet të bazuara në efijencë kërkojnë me Ligjin për Ndërtimet dhe secili shfrytëzues kërkojnë të pajiset me certifikatën për shfrytëzim, e cila kushtëzohet me masat e efijencës së energjisë¹². Megjithatë, zbatimi i ligjit nuk ka qenë i duhur.

Zhvendosja e kuadrit ligjor të Komunitetit të Energjisë në fushën e efijencës së energjisë është një proces mjaft kompleks dhe kërkon hartimin e ligjeve të reja. Kosova duhet të ketë ligjet e saj në përputhje me Direktivat e BE-së, pasi ajo është nënshkruese e Traktatit të Komunitetit të Energjisë, kështu që direktivat e mëposhtme të energjisë janë obliguese edhe në Kosovë: Direktiva 2006/32/EC mbi efijencën e energjisë dhe shërbimeve energjetike; Direktiva 2010/30/EU për treguesit përmes etiketimeve dhe

10 Eptisa, Studim kombëtar rreth efijencës së ndërtesave në Kosovë, Prill 2013.

11 Ligji No. 04/L-110 për Ndërtimet. Kosovë. Neni 6

12 Ligji No. 04/L-110 për Ndërtimet. Kosovë. Neni 27.

informacionet standarde të prodhimeve rreth konsumit të energjisë dhe burimeve të tjera nga prodhimet e lidhura me energjinë; Direktiva 2010/31/EU për performansën energjetike të ndërtesave, të mbështetura nga një grup i direktivave implementuese.

Me qëllim të ndërmarrjes së masave të efijencës, Kuvendi i Kosovës duhet të emërojë një Task Forcë të posaçme për të monitoruar zbatimin e kornizës ligjore që rregullon efijencën. Ky duhet të radhitet si një ndër prioritetet kryesore të Kuvendit të Kosovës.

Ekonomitë familjare vazhdojnë të konsumojnë më shumë se 78% të energjisë së përgjithshme në Kosovë. Rrjedhimisht, masat e efikasitetit për ekonomitë familjare do të shkaktonin ndryshime të rëndësishme të kërkesës për energji. Masat që politikat publike mund të sigurojnë dhe stimulimet për këtë sektor janë të shumta. Masa e parë është ofrimi i alternativave për ngrohjen e hapësirave dhe stimulimet për këto alternativa, gjersa sanksionon përdorimin e energjisë elektrike për këtë qëllim. Masa e dytë është nxitja e ekonomive familjare për të izoluar shtëpitë e tyre, sidomos duke pasur parasysh të dhënat që flasin për 70% të familjeve të cilët jetojnë në hapësira joefijente¹³. Stimulimet do të mundësoheshin përmes shfrytëzimit të fondeve të zotuar nga Institucionet Financiare Ndërkombëtare për efijencën e energjisë.

Projektet e efijencës së energjisë të kryera deri më tani në Kosovë nga institucionet financiare ndërkombëtare dhe donatorët bilateralë tregojnë se fondet e dhuruara ose të dhëna hua për këtë qëllim kanë qenë jashtëzakonisht të kufizuara. Për më tepër, shumica e këtyre projekteve kanë në shënjestër vetëm ndërtesat publike. Përfundimisht bën linja kreditore 12 milionëshe e Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZh) përmes bankave afariste, e cila përqendrohet në sektorin e banesave dhe ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme (NVM) dhe linja kreditore e KFW-së përmes “Raiffeisen” dhe “ProCredit” cilat kanë pasur qëllime të ngjashme dhe secila ka ndarë rreth 10 milionë euro. Për këto të fundit, kreditë e dhëna vlerësohet të ketë arritur vetëm 1% të tregut potencial¹⁴. Mbështetja financiare për banim me efijencë të energjisë paraqet një potencial të madh të pashfrytëzuar, në qoftë se ajo është e përballeshme për një shtresë të gjerë të popullsisë.

Janë rreth 61.2 milion euro¹⁵ të zotuar të Kosovës për projekte dhe masa të efijencës së energjisë. Deri më tani ato nuk janë shfrytëzuar si duhet, kryesisht për shkak të mungesës së ideve dhe politikave.

Me qëllim të vendosjes së efijencës së energjisë si prioritet të lartë, Kosova duhet të krijojë një Fond për efijencën e energjisë. Ky fond do të menaxhohej bashkërisht nga Qeveria e Kosovës, shoqëria civile si dhe të gjitha institucionet financiare ndërkombëtare që do të kontribuonin në të. Fondi do të shërbente si “arkë” për të gjitha investimet,

13 Fletënotim për energjinë elektrike, Konzorciumi Kosovar i Shoqërisë Civile për Zhvillim të Qëndrueshëm, Gusht 2013.

14 Eptisa, Studim Kombëtar rreth efijencës së ndërtesave në Kosovë, Prill 2013.

15 IFI grantet dhe projektet

ndihmat e huaja dhe kreditë që do të dedikoheshin në fushën e efijencës së energjisë. Fondi do të përdorej për të financuar projekte me shkallë të ulët dhe të lartë të efijencës. Një pjesë e mirë e këtij fondi do të shfrytëzohej për sigurimin e granteve të vogla dhe kredive me kamata të ulëta për ekonomitë familjare, që do të përdorëshin vetëm për masa të efijencës së energjisë. Vetëm familjet që jetojnë nën kufirin e varfërisë do të gëzonin të drejtën të aplikojnë për grante të efijencës së energjisë.

Auditime në fushën e energjisë duhet të bëhen në mënyrë të pavarur dhe të vihen në dispozicion të të gjithë sektorëve të energjisë dhe konsumatorëve, duke filluar nga ato më të voglat familjare, atyre afariste e deri te konsumatorët industrialë të vegjël dhe të mesëm.


Kosova duhet të sigurojë skemë efijente të auditimit të energjisë të projektuar për të kontrolluar përputhshmërinë e aktiviteteve industriale dhe instalimeve të shërbimit private ose publike me legjislacionin përkatës kombëtar për zbatimin e Acquis të BE-së në efijencën e energjisë. Gjatë dizajnit të skemave të tilla, qeveria duhet të marrë parasysh legjislacionin përkatës në lidhje me certifikimin e performancës energjetike të ndërtesave.

Është e rëndësishme që të gjitha produktet në dispozicion në treg të ndërlidhura me energji të plotësojnë kushtet dhe kërkesat e përcaktuara me rregullore të veçantë për ekodizajn. Etiketimi i produkteve duhet të përfshijë informacione për efijencën e energjisë.

Në mënyrë që ky program intensiv i efijencës të jetë efektiv, Qeveria e Kosovës duhet të përdorë “shkopinjë dhe karotë” e duhura. Në njërin anë, familjeve duhet t’u jepet mundësia për të investuar në efijencë, përmes granteve të vogla për familjet e varfra, apo mundësive për kredi me kamata të ulëta me një periudhë të përshtatshme mospagimi për ata mbi kufirin e varfërisë. Ky sistem i stimulimeve do të duhej të bëhej i mundur përmes krijimit të Fondit për Efijencë të Energjisë i cili përfaqëson “karotë të fuqishme” për politika të efijencës.

Një “shkop solid” duhet të shoqërojë këtë karotë. Sistemi i tatimeve mbi pronën është një platformë e përshtatshme që do të mund të përdorej për këtë qëllim. Pasi të jetë kryer auditimi i të gjitha ndërtesave publike dhe ekonomive familjare private, komunat e Kosovës do të përdornin të dhënat e auditimit për rikategorizimin e çdo ndërtese, duke marrë parasysh performancën e tyre të efijencës. Në këtë mënyrë, ndërtesa me efijencë më të lartë do të paguante më pak tatime, se sa ato me efijencë më të ulët ose pa efijencë.

Kosovarët paguajnë **52% më shumë** për energji elektrike në krahasim me shtetasit e BE-së



Energji elektrike e përbalueshme

Tarifat e energjisë elektrike kanë qenë një nga çështjet më të diskutueshme në kuadër të sektorit të energjisë së Kosovës në vitet e fundit. Kjo ka ndodhur kryesisht për shkak të rritjes së vazhdueshme të tyre nga Zyra e Rregullatorit të Energjisë (ZRRrE) e cila nxititi një varg protestash nga qytetarët në fillim të vitit 2013. Pasi që KOSID-i promovon mundësitë për zhvillim të qëndrueshëm në sektorin e energjisë, përbalueshmëria e tarifave të energjisë elektrike është një element i rëndësishëm që duhet të adresohet, për shkak të ndikimit të saj të drejtpërdrejtë në mirëqenien e qytetarëve.

Në krahasim me vendet e tjera të rajonit, Kosova paguan më shumë për kilovat/orë se Serbia dhe Maqedonia, ndërsa paguan më pak se Shqipëria, Bosnja e Hercegovina dhe Mali i Zi. Vendet anëtare të BE-së paguajnë një çmim mesatar prej 14.16 centë për kWh¹⁶ ose 3 herë më shumë se Kosova. Megjithatë, përveç faktit që kosovarët paguajnë një çmim relativisht të ulët në krahasim me rajonin, në qoftë se marrim parasysh standardin e jetesës dhe fuqinë blerëse¹⁷, bëhet e qartë se kosovarët paguajnë mesatarisht 52% më shumë për energji elektrike në krahasim me shtetasit e ndonjë vendi tjetër në rajon ose BE¹⁸.

Në bazë të shqyrtimit të shtatë të Tarifave të Energjisë Elektrike - ETR7 (2013-2017)¹⁹ nga ZRRrE-ja, çmimi i tanishëm i energjisë elektrike i zbatueshëm në Kosovë është i vlefshëm vetëm deri në 31 mars 2014. Në të vërtetë ZRRrE-ja tashmë ka shqyrtuar tarifatat aktuale të cilat pritet të rriten këtë vit. Përveç kësaj, në Punimin Konsultativ për Strukturën e Tarifave²⁰ të fundit, të publikuar në shkurt të vitit 2014, ZRRrE-ja ka analizuar edhe mundësinë e riorganizimit të plotë të strukturës së tarifave duke futur një tarifë të sheshtë dhe skenarët e ndryshëm të mundshëm, si: eliminimin e bllok tarifave, eliminimin e tarifës së lartë dhe të ulët dhe eliminimin e sistemit sezonal. Pavarësisht nga kompleksiteti i sistemit aktual të tarifave të energjisë elektrike në Kosovë, KOSID-i konsideron se sistemi tarifor aktual për situatën aktuale socio-ekonomike është më i përshtatshmi.

16 Electricity - domestic consumers - bi-annual prices - new methodology from 2007 onwards
<http://appsso.eurostat.ec.europa.eu/nui/submitViewTableAction.do>

17 I llogaritur në bazë të raportit të çmimit të energjisë me BPV per Capita me terma PPP (Pariteti i Fuqisë Blerëse: Internacional \$)

18 Çmimi i energjisë elektrike:: trendet dhe ndikimi ekonomik (GAP & FIQ), Mars 2013

19 http://ero-ks.org/Tarifat/2013/Proceset%20e%20Shqyrtimit/eng/Evaluation_Overview_27_March_2013.pdf

20 http://ero-ks.org/Tarifat/2014/Raporti_konsultativ_per_strukture_tarifore.pdf

Çmimi i energjisë në Kosovë u ngrit disa herë gjatë dekadës së fundit. Vetëm gjatë vitit 2012, faturat e energjisë elektrike të qytetarëve të Kosovës u rritën për 8.9%. Trendi i shtrenjtimit të energjisë elektrike nuk përputhet me trendët e rritjes ekonomike të vendit. Sipas indikatorëve preliminarë, çmimi i energjisë elektrike do të vazhdojë të rritet gjatë viteve të ardhshme, duke e bërë edhe më të vështirë përballimin e faturave e energjisë elektrike për qytetarët e Kosovës.

Duke pasur parasysh faktet dhe të dhënat e paraqitura më lart, KOSID i bën thirrje Qeverisë së Kosovës që të marrë masa të menjëhershme në drejtim të zhvillimit dhe prezantimit të politikave të domosdoshme dhe ndërtimit të mekanizmave për të adresuar përballueshmërinë e tarifave të energjisë elektrike për qytetarin e saj. Ulja ose heqja e TVSh-së për energjinë elektrike, duke ulur tarifat për linjitin e përdorur në Kosovë dhe duke rritur faktorin e efijencës, janë vetëm disa elemente që do të kishin ndikim të drejtpërdrejtë në përballueshmërinë e çmimit të energjisë elektrike në Kosovë.

Tregu dhe integrimi

KOSID mbështet përshtatjen e legjislacionit të Kosovës me Pakon e Tretë të Direktivës së BE-së për Energji Elektrike, si mjet për liberalizimin gradual të tregut dhe depërtimin e sistemit energjetik të Kosovës në tregun rajonal të energjisë. Sa i përket strukturës së tregut, KOSID-i mbështet liberalizimin gradual të shkallës së furnizimit të tregut, me synimin për ta bërë atë konkurrues, por edhe të përgjegjshëm në aspektin social. Sa i përket zhvillimit institucional, KOSID-i kundërshton fuqishëm politizimin e Zyrës së Rregullatorit të Energjisë, si mënyrë e vetme për të ruajtur rolin e saj neutral në tregun energjetik. Përveç kësaj, KOSID-i mbështet fuqizimin e ZRrE-së me mjete të tjera mbrojtëse të konsumatorit dhe mekanizma për të luftuar sjelljet abuzive të operatorëve të energjisë në treg.

Zhvillimi dhe mirëmbajtja e një rrjeti të përshtatshëm të energjisë elektrike është jetik për sigurimin e furnizimit me energji me kosto më të ulët. Rrjeti i energjisë në Kosovë nuk është i lidhur mirë me vendet fqinje. Një kapacitet më i mirë i lidhjeve ndërkufitare do të bënte vendin një qendër të rëndësishme rajonale të transmetimit të energjisë.

Aktualisht (sipas të dhënave të vitit 2010) Kosova me vendet fqinje ka lidhjet në vijim:

Kosovë - Serbi - 730 kV

Kosovë - Maqedoni - 400 kV

Kosovë - Mali i Zi - 400 kV

Kosovë - Shqipëri - 220 kV

Një linjë shtesë 400 kV që lidh termocentralin “Kosova B” me “Kasharin” (Tiranë) është në zhvillim e sipër. KOSID-i mbështet një linjë tjetër 400 kV mes Kosovës dhe Maqedonisë, si mënyrë për të lidhur Kosovën me tregun rajonal që do të mundësonte depërtimin në tregun rajonal të energjisë pas vitit 2015, në bazë të Traktatit të Komunitetit të Energjisë. Është e rëndësishme që zhvillimi i ardhshëm i rrjetit të brendshëm dhe atij ndërkufitar të transmisionit të energjisë të marrë parasysh kapacitetet gjeneruese të energjisë së rinovueshme të Kosovës dhe kapacitetet për energji të rinovueshme në rajon. Për këtë arsye, linjat më të mira konektuese do të duhej të ishin të obligueshme.

Ne bëjmë thirrje për një studim të ri mbi ndikimin e energjisë së rinovueshme dhe planeve të efikasitetit të energjisë në rajon, në sistemin e transmisionit dhe shpërndarjes së energjisë të Kosovës, të përcjellë me diskutime të gjera me qytetarë dhe ekspertë të fushës si dhe me ndryshimin e Planit Zhvillimor të Transmisionit të Kosovës (2010 -2019) i cili duhet të pasqyrojë plotësisht burimet e rinovueshme dhe zhvillimet në Evropën Juglindore.

Shëndeti dhe Mjedisi

Industria dhe prodhimi / konsumi i energjisë numërohen ndotësit më të mëdhenj mjedisorë në Kosovë²¹. Ndotës tjerë të mjedisit janë transporti, bujqësia dhe aktivitetet e deponimit të mbeturinave. Ndotja e ajrit për shkak të industrisë dhe prodhimit të energjisë ka përkeqësuar gjendjen shëndetësore të popullatës me dëme të cilat vlerësohen deri në 163 milionë euro²² në vit, për shkak të sëmundjeve kardio-respiratore dhe kancerit në mushkëri. Ndotja e ajrit ka rritur edhe mortalitetin me të paktën 852 vdekje të parakohshme në vit.

Situata e përgjithshme në sektorin e shëndetësisë në Kosovë (normat e larta neonatale, perinatale dhe vdekshmërisë maternale) nënkupton se popullsia e Kosovës është gjithnjë e më e ndjeshme ndaj ndotjes së mjedisit. Kjo do të kontribuojë në indikatorët tashmë negativë të shëndetësisë dhe të gjitha këto ndikime negative detyrojnë qytetarët të kërkojnë më shumë shërbime shëndetësore – pasi të shteren resurset e kufizuara në sektorin publik, qytetarët do të detyrohen të shpenzojnë më shumë për shërbime shëndetësore dhe kjo do të thotë nivel më i lartë i varfërisë^{23, 24}.


Cilado politikë publike që hartohet dhe zbatohet pa marrë parasysh shëndetin e popullatës, nuk do të jetë e qëndrueshme dhe do të jetë kundër produktive. Shoqëria kosovare nuk mund të përballojë më gjatë injorimin e pasojave të politikave publike në shëndetin e popullatës kosovare, duke përfshirë edhe humbjen e jetëve. Të gjitha instrumentet e paraqitura në këtë dokument paraqesin zgjidhjet optimale duke marrë parasysh një vlerësim gjithëpërfshirës shëndetësor dhe mjedisor.

21 WHO Regional Office for Europe (2012) Environmental Health Mission, Report, Draft version for consultation with stakeholders

22 World Bank (2013) Kosovo Country Environmental Analysis

23 Bredenkamp et al (2011) Catastrophic and impoverishing effects of health expenditures: a new evidence from the Western Balkans, Health Policy and Planning 26: 349-356

24 Garg et Karan (2009) Reducing out-of-pocket expenditures to reduce poverty: a disaggregated analysis at rural-urban and state level in India, Health Policy and Planning 24:116-128



2014